

# Prokurimi publik në Ministrinë e Infrastrukturës



---

# **Transparenca dhe llogaridhënia në Prokurimin Publik**

Ministria e Infrastrukturës

Mars, 2014

---

Ky raport financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë, si pjesë e projektit “Transparenca dhe Llogaridhënia në Prokurimin Publik”, i cili synon përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të prokurimit publik, si dhe përmirësimin e efektivitetit në zbatimin e legjislacionit në tre ministri: Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Infrastrukturës (MI), si dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB).

Qëndrimet e shprehura në raport janë të autorëve, ato nuk janë domosdoshmërisht qëndrime të donatorit.

Përgatitur nga: Merita Mustafa, Isuf Zejna dhe Driton Selmanaj.

Të drejtat autoriale i ka KDI. Çdo do të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim rishfrytëzimi, të emertohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjete elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. © KDI\TIK, dhjetor 2014.



British Embassy  
Pristina

---

## Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	4
Hyrje	6
Metodologjia	7
Transparenca në Ministrinë e Infrastrukturës	8
Ndëshkimet Ndaj Operatorëve Ekonomik	10
Ankesat e operatorëve ekonomik ndaj Ministrisë së Infrastrukturës të adresuara në OSHP gjatë vitit 2013	10
Tenderët për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe rajonale	13
1. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Prishtina A, Kontrata me Kompaninë Arbotec	14
2. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Prishtina B, Kontrata me Kompaninë Integral	16
3. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin e Pejës, Kontrata me Kompaninë Graniti	17
4. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin e Prizrenit, Kontrata me Kompaninë Drini	18
5. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin e Ferizajt, Kontrata me Kompaninë Damastion-Eurokos-Urban-Unicom	19
6. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Mitrovicë, Kontrata me Kompaninë Jasen	20
7. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Gjakovës	21
8. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Gjilanit	22
9. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Mitrovica A	24
Dallimi i Çmimeve për Punët e Njëjta	24
10. Tenderi për Asfaltimin e rrugës lokale në fshatin “Suriganë” - Komuna e Istogut	26
Fituesi i tenderit	27
11. Tenderi për Asfaltimin e rrugës lokale në fshatin Prekallë - Trubohovc	28
12. Tenderi - Ndërtimi i rrugës Pejë Tërstenik	30
Rekomandime	32

## **Përmbledhje Ekzekutive**

Ministria e Infrastrukturës është dikasteri që merr buxhetin më të madh vjetor në fushën e investimeve kapitale. Duke marr për bazë këtë buxhet kaq të lartë, konsiderojmë se edhe mbikëqyrja duhet shtuar mbi këtë se si po menaxhohen këto fonde publike. Qeveria e Kosovës në dy mandatet e fundit por jo vetëm, e ka vënë top prioritet ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe mirëmbajtjen e saj, për çka pjesa më e madhe e projekteve kapitale në fushat e tjera si shëndetësia, arsimi apo edhe kultura, është dashur të minimizohen. Sektorët e tjerë në çdo rast kanë pasur më pak prioritet sesa rrugët, sado që në kuptim të nevojave për qytetarët kanë genë shumë më të nevojshme sesa ndërtimi i infrastrukturës rrugore.

Qytetarët e Kosovës ashtu sikurse edhe organizatat e shoqërisë civile nuk e shohin me sy të mirë menaxhimin e parasë publike nga kjo Ministri, për të cilën tashmë ka një numër të madh të raporteve dhe shkrimeve për keq-menaxhim dhe keqpërdorime, si dhe për faktin se aktualisht po zhvillohen edhe procese gjyqësore. Në këtë rast janë akuzuar zyrtarët më të lartë të kësaj Ministrie, duke përfshirë ish Ministrin e Transportet dhe Post-telekomunikacionit (paraardhëse e Ministrisë së Infrastrukturës) si dhe Drejtorin aktual të Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës. Kjo Ministri në punën e saj është përcjell edhe me nivel shumë të ulët të transparencës, duke mos i plotësuar as standardet minimale të cilat i ka garantuar legjislacioni vendor. Për më keq, Ministria e Infrastrukturës, ka shkelur jo vetëm Ligjin e Qasjes në Dokumente Publike, por edhe vet Ligjin e Prokurimit Publik, kur nuk ka publikuar kontratën e projektit të ndërtimit të autostradës, Morinë-Merdare.

Ligji i Prokurimit Publik, ka paraparë që përkundër sekreteve afariste që mund të kenë kontratat e caktuara, çmimet e kontratës nuk mund të jenë asnjëherë pjesë e trajtimit të kësaj dispozite. Përkundër dispozitave të qarta ligjore, Ministria e Infrastrukturës asnjëherë nuk ka bërë publike çmimet për njësi dhe as kontratën e autostradës. E njëjta frymë e funksionimit e ka shoqëruar edhe këtë hulumtim, ku Ministria në pjesën më të madhe të projekteve nuk ka pranuar t'i shpalosë ofertat e operatorëve ekonomik. Madje edhe dokumentet bazë si kontratat dhe raportet e vlerësimit janë marr vetëm pas më shumë se shtatë muajsh pritje dhe insistimi.

Një fenomen tjetër shumë i dyshimtë janë edhe gabimet aritmetikore të cilat përcjellin një numër të madh të tenderëve nga ku në mënyrë të dyshimtë vendosen fituesit e tenderit dhe lartësia e monetare e kontratave. Kështu, në disa raste, konkurrentëve i janë rritur vlerat e ofertave deri në masën sa nuk e kanë kaluar ofertën konkurrencte dhe në rastin tjetër konkurrentëve i janë ulur vlerat e ofertës deri në atë masë sa për të shpallur fitues njërën kompani. Këto gabime nuk kanë mundur të vërtetohen nëse kanë qenë të qëllimshme ose jo, si pasojë e mungesës së qasjes në ofertat e kompanive për të parë se si është e mundur që në një ofertë relativisht të thjeshtë kompanitë të gabojnë në kalkulimet e çmimeve për njësi. Raporti tenton të hedh dritë edhe mbi çështje të tjera të vlerësimit të ofertave, siç janë dallimet e mëdha në mes të çmimeve për njësi, ku të njëjtat punë paguhen me çmime pakrahasimisht të ndryshme me dallime deri në shtatë fish, apo edhe më shumë.

## Hyrje

Është e kuptueshme se një shteti të ri siç është Kosova, e dalë nga një luftë me dëme të konsiderueshme, iu deshën dhe do t'i duhen shumë fonde dhe shumë projekte për t'u rindërtuar. Ky rindërtim, nënkupton, ndërtimin e infrastrukturës bazë, ndërtimin e shkollave, spitaleve dhe objekteve të tjera që janë në shërbim të qytetarëve. Rindërtimi po ashtu do të thotë se kur të gjitha këto shndërrohen në projekte kapitale ato në fund përkthehen në realizimin e proceseve tenderuese. Përpos tyre, tender do të thotë edhe kontraktimi i shërbimeve të ndryshme dhe blerja e mallrave që kanë për qëllim furnizimin e institucioneve me materialet e nevojshme.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/ Transparency International Kosova (TIK), që nga viti 2011 është përcaktuar që t'i kushtoj vëmendje të posaçme prokurimit publik, për faktin se ky sektor për çdo vit konsumon mbi 50 % të buxhetit publik, dhe po ashtu për faktin se mekanizmat aktual të kontrollit nuk janë të aftë dhe të gatshëm sa duhet, për të vërë rregull dhe kontroll në këtë sektor.

Ajo që i ka shkaktuar dëmin më të madh këtij sektori është mungesa e vëmendjes dhe përkushtimit të aktorëve politik për të rritur transparencën e këtij sektori, për të forcuar politikat dhe mekanizmat e tjerë, të cilët do të duhej të kishin për qëllim stopimin e keq menaxhimit dhe parregullsisë. Kjo detyrimisht ka bërë që ky sektor të mbetet vazhdimisht i rrezikuar nga prania e fenomenit të korrupsionit.

Disa nga indikatorët më të rëndësishëm që tregojnë se korrupsioni është i pranishëm në këtë sektor janë kualiteti i dobët i rrugëve dhe prishja e shpejtë e tyre si dhe kualiteti i dobët i ndërtimit të shkollave dhe ndërtesave të tjera. Shumica e defekteve shfaqen qysh në vitin e parë pas inaugurimit, e disa madje nuk arrijnë as të përurohen për shkak të defekteve që paraqiten qysh në fazat fillestare të realizimit të punëve. Indikator tjetër pa dyshim se janë edhe çmimet shumëfish më të shtrenjta sesa çmimet normale të tregut, mos arritja e sasisë dhe mallrave të porositura, porositja e mallrave të panevojshme për të favorizuar kompaninë të caktuara, blerja e pajisjeve defektuozë etj.

Indikator tjetër që fletë për prani të madhe të korrupsionit në këtë sektor është edhe pasuria e zyrtarëve të lartë. Duke marr parasysh se disa nga

pagat e zyrtarëve publik asnjëherë nuk mund të justifikojnë shpenzimet dhe luksin më të cilin ata jetojnë, marrja e mitos në shkëmbim të përfitimit të një pasurie të paligjshme, vazhdon të mbetet një prej formave më të shpeshta të krijimit të pasurisë. Duke marr parasysh të gjitha këto, KDI në këtë hulumtim analizon tenderët e realizuar në Ministrinë e Infrastrukturës, duke evidentuar shkeljet ligjore dhe parregullsitë e ndryshme të cilat qojnë në konkluzione jo të mira, e që lënë një përshtypje se paraja publike në këtë sektor vazhdon të shpenzohet pakujdesshëm dhe shoqëruar me shumë elemente korruptive.

Në këtë raport janë analizuar gjithsejtë 12 kontrata dhe tenderë të Ministrisë së Infrastrukturës, për mirëmbajtjen e rrugëve dhe ndërtim të rrugëve lokale, nga të cilat janë nxjerr përfundime dhe analiza lidhur me rregullsinë e proceseve tenderuese dhe formën e menaxhimit të parasë publike, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës.

## **Metodologjia**

Metodologjia e hulumtimit në këtë raport tenton të mat zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, përmes ekzaminimit të disa tenderëve të cilët janë analizuar në faza të ndryshme. Si mostër për këtë raport, janë analizuar 12 tenderë, ku përparësi në përzgjedhje kanë pasur tenderët me vlerë të lartë. Nga tenderët e përzgjedhur, shumica prej tyre kanë qenë në fazën e zbatimit të kontratës, ndërsa për disa prej këtyre tenderëve ka pasur edhe ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Për shkak të natyrës së tenderëve të përzgjedhur, analiza trajton dy faza të prokurimit, duke filluar nga shpallja e tenderit e deri tek faza e përzgjedhjes së fituesit. Përpos tyre, kjo metodologji trajton nivelin e transparencës, gjobat e shqiptuara ndaj operatorëve ekonomik si dhe ankesat e deponuara në OSHP. Gjithashtu, kjo metodologji e hulumtimit dhe monitorimit të prokurimit publik përdorët gjerësisht nga organizatat mbikëqyrëse dhe kryesisht nga degët e Transparency International nëpër shtete të ndryshme. Dokumentet të cilat janë përdorur gjatë ekzaminimit të tenderëve janë: raportet e vlerësimit të tenderëve, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontrata, dosjet e tenderëve, ofertat



e operatorëve ekonomik, kontratat publike, vendimet e OSHP-së, raportet e ekspertizës, ankesat e operatorëve, etj.

## **Transparenca në Ministrinë e Infrastrukturës**

Në kuadër të monitorimit të prokurimit publik, në institucionet qeveritare, një nga shtyllat më të rëndësishme të matjes së mirë menaxhimit është transparenca që këto institucione tregojnë përballë hulumtimit. Një parim i pranuar përgjithësisht thotë se transparenca është dezinfektuesi më i mirë. Nëse ky kriter përdoret si matës në rastin e Ministrisë së Infrastrukturës, atëherë arrijmë në përfundime të hidhura, kjo pasi që qasja në dokumentet e këtij institucioni, ka qenë e vështirë e në shumë raste edhe e pamundur.

Duke kujtuar se Ministria e Infrastrukturës është një nga organizatat buxhetore e cila më së shumti shpenzon në investimet kapitale, atëherë edhe rëndësia e qasjes në informata për mënyrën e menaxhimit të këtyre mjeteve është cruciale. Zyrtarët e Ministrisë nuk kanë treguar vullnet që t'i përgjigjen me të dhëna sqaruese hulumtimit, përkundrazi nga ana e Ministrisë ka pasur vetëm zvarritje të paarsyeshme dhe pengesa të tjera të cilat kanë penguar procesin e hulumtimit.

Për të realizuar këtë hulumtim KDI, i ka kërkuar dokumente Ministrisë së Infrastrukturës për 9 procedura tenderuese dhe mbi pesëmbëdhjetë kontrata, të cilat janë injoruar për shtatë muaj me radhë. Për të realizuar qasjen në dokumente publike të grantuar edhe me ligj, KDI ka shfrytëzuar edhe mekanizmin e fundit, atë të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), duke parashtruar ankesë tek ky institucion. Ky i fundit, nxjerri konstatimin se MI ka bërë shkelje esenciale të të drejtave të njeriut, duke vepruar në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet e vendit si dhe aktet ndërkombëtare përkatëse. Përpos kësaj, IAP i rekomandoi Ministrisë së Infrastrukturës që t'i lejojë qasje KDI-së në dokumentet e kërkuara dhe paralelisht të vë në përgjegjësi disiplinore zyrtarët të cilët e zvarritën këtë kërkesë për qasje në dokumente.

Zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës kanë vepruar fillimisht në përmbushje të këtij rekomandimi të Avokatit të Popullit dhe kanë ofruar një numër të dokumenteve kopje në dispozicion të hulumtuesve tanë. Megjithatë, për shkak të volumit të madh të dokumenteve zyrtarët e

Ministrisë kanë kërkuar që për ofertat e operatorëve ekonomik, qasja të jetë direkt në arkivat e këtij institucioni, duke i vënë në shërbim të hulumtimit dhe fotokopjuar vetëm pjesët esenciale sipas kërkesave eventuale. Mirëpo, edhe përkundër këtyre zotimeve për qasje të plotë dhe të pa penguar, Ministria e Infrastrukturës ka lejuar qasje vetëm në një tender dhe atë për një projekt të vogël i ashtuquajtur Asfaltim i rrugës së fshatit Suriganë. Ndërkaq, qasja nuk është lejuar në nëntë llojet e ofertave për tenderin e Mirëmbajtjes së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale dhe ofertave të projektit të ndërtimit të rrugës Prekallë – Trubohovc.

Në përgjithësi, nga monitorimi i prokurimit publik nëpër institucionet e Kosovës, KDI ka vërejtur se Ministria e Infrastrukturës është institucioni më i mbyllur përkatësisht më jo transparent me të cilin KDI është ballafaquar. Kjo, gjithsesi se bazohet nga përgjigjet që janë marr në faza të ndryshme prej kur ka filluar monitorimi në vitin 2011. Ministria e Infrastrukturës po ashtu ka një arkiv të pa organizuar dhe kaotik, ku ruajtja e dokumenteve është krejt e pa organizuar dhe e pa sigurt. Në shumë raste zyrtarët e Ministrisë me ose pa qëllim nuk kanë mundur as t'i gjejnë dokumentet e kërkuara për qasje, duke u arsyetuar se nuk kanë një arkiv të vetëm por janë disa lokale të ndara ku bëhet ruajtja e dokumenteve.



Komunikimet me Ministrinë e Infrastrukturës, kanë qenë veçanërisht të vështira pas kryerjes së pjesës së parë të hulumtimit më 2011, kur Ministria kishte marr vendim që “të ndërpres bashkëpunimin” me organizatën tonë, duke i konsideruar jo korrekte raportet e KDI-së dhe deklaratimet në media. Kjo ka bërë që rreth shtatë muaj, pa asnjë arsytim ligjor Ministria e Infrastrukturës përveç që nuk ka lejuar qasje në dokumente zyrtare, ajo nuk ka marr as mundin që t'i përgjigjet negativisht me shkrim kërkesave

tona. Mbas ankesës tek Avokati i Popullit kjo Ministri i ka ofruar KDI-së të bëjë nënshkrimin e një memorandumit të bashkëpunimit, me të cilin do të viheshin disa rregulla minimale në konsultimet e KDI-së me Ministrinë e Infrastrukturës, para se raportet të publikoheshin. Megjithëse një memorandum i tillë ishte kërkuar nga vetë Ministria dhe i njëjti që draftuar dhe negociuar nga zyrtarët e dy institucioneve, Ministri asnjëherë nuk e nënshkroi këtë memorandum.

## **Ndëshkimet Ndaj Operatorëve Ekonomik**

Autoritetet kontraktuese në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave, kryesisht përdorin dy metoda të disiplinimit të kompanive të cilat bëjnë vonesa të pa arsyeshme në zbatimin e kontratave; Ato japin gjoba në vlera monetare për kompanitë, apo në rastet kur shkeljet e dispozitave kontraktuese janë më serioze ata ndërprejnë në mënyrë të njëanshme këto kontrata. Gjodat ndaj operatorëve ekonomik janë një nga shtyllat e raporteve të monitorimit të prokurimit publik të cilat KDI/TIK u bënë organizatave buxhetore.

Në këtë drejtim, Ministria e Infrastrukturës, është përgjegjës në kërkesën tonë për të marr informata mbi gjobat e shqiptuara, se në tre vitet e fundit përkatësisht vitet 2011, 2012 dhe 2013, nga departamentet e mbikëqyrjes nuk ka marr asnjë informatë për vonesa të pa justifikueshme të operatorëve ekonomik, andaj MI nuk ka ndarë asnjë gjobë ndaj asnjë operatori. Kjo situatë më shumë vë në pah një mbikëqyrje të dobët të kontratave, sesa që është bindëse se me të vërtetë nuk ka vonesa nga operatorët ekonomik.

## **Ankesat e operatorëve ekonomik ndaj Ministrisë së Infrastrukturës të adresuara në OSHP gjatë vitit 2013**

Gjatë vitit 2013 operatorët e ndryshëm ekonomik kanë adresuar ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) i cili është agjencioni kompetent për shqyrtimin e ankesave. Numri i ankesave të adresuara nga operatorët ekonomikë kundër Ministrisë së Infrastrukturës si autoritet kontraktues gjatë vitit 2013 kap shifrën e 39 ankesave.

Aspekti sasior i numrit të ankesave nuk dallon shumë nga viti paraparak 2012, ku operatorët ekonomikë kishin adresuar në OSHP 40 ankesa. Dallimi qëndron në numrin e ankesave të shqyrtuara nga ana OSHP-së, ku për shkak të mungesës së bordit të këtij institucioni, nga 39 ankesa gjatë vitit 2013 ka trajtuar vetëm 17 prej tyre, kurse 22 nuk janë shqyrtuar fare.

Nga ankesat e shqyrtuara, OSHP në 6 raste ka aprovuar vendimet e autoritetit kontraktues, në rivlerësim ka dërguar 7 raste, në ri-tenderim ka dërguar 1 rast, ka hedhur poshtë 2 ankesa, kurse 1 rast parashtruesi i ankesës e ka tërhequr ankesën.

Në shumicën e rasteve janë atakuar tenderët me nga një ankesë të vetme nga një operator i caktuar ekonomik. Ndërsa janë identifikuar edhe disa raste tjera ku ka pas numër më të madh të operatorëve që kanë adresuar ankesa lidhur me një tender të caktuar. Ndër rastet me numrin më të madh të ankesave ndaj një tenderi, është identifikuar tenderi me titull “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale të Republikës së Kosovës” me numër të aktivitetit të prokurimit: MI 1303050511, ndaj të cilit operatorët ekonomik kanë parashtruar 3 ankesa. Ankesa kanë parashtruar këta operatorë ekonomikë: Tekno Ing Consulting SHpk, Jona Shpk dhe RSM Company shpk.

Duhet konstatuar se të tri ankesat lidhur me këtë tender, kishin të bënin me pretendimet e operatorëve, se autoriteti kontraktues kishte bërë kufizime dhe kushtëzime në procedurën tenderuese të cilat kanë efekte negative në zhvillimin e biznesit, pasi që janë favorizuar bizneset që kanë kontrata që 10 vite me MI dhe kanë krijuar monopol.

Po ashtu me tre (3) ankesa është atakuar edhe tenderi me titull “Ndërtimi i rrugës në hyrje të qytetit të Pejës nga Prishtina” me numër të aktivitetit të prokurimit MI13066511. Ndaj këtij tenderi ankesa kishin parashtruar: RSM Company shpk, “Asfalti”& “Enginiering”&”ARFA” dhe Konsorciumi “Lika Trade”shpk & Conex Group Shpk. Këta operatorë ekonomikë kishin pretendime se autoriteti kontraktues kishte shkel disa nga nenet e Ligjit për Prokurim publik duke i shpallur këta operatorë si të papërgjegjshëm, për shkak të mos kompletimit të dokumenteve sipas dosjes së tenderit.

Natyra e ankesave tjera të operatorëve ekonomik kishin të bënin me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik, duke u nisur nga mos respektimi i kriterit për çmimin më të lirë, mos respektimin e kriterëve (kërkesave) minimale të gjendjes ekonomike-financiare, aftësitë teknike dhe profesionale e deri tek kriteret favorizuese.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të adresuara në OSHP, 11 nga operatorët ekonomik në ankesat e tyre kishin ngritur shqetësim mbi vlerësimin e autoritetit kontraktues lidhur me mos plotësimin e kriterëve që kishin të bënin me kriteret për përshtatshmërinë e aftësive profesionale të saktësuara në dosjen e tenderit (Diploma dhe realizimi i së paku 2 projekteve sa  $\frac{1}{2}$  e vlerës së ofertës nga ana e menaxherit të projektit; Pasqyra vjetore për të punësuarit nga ATK etj).

Gjithashtu tetë (8) nga operatorët ekonomikë kishin adresuar ankesë ndaj autoritetit kontraktues, për shkak se ishin shpallur të papërgjegjshëm meqë nuk kishin plotësuar standardet për gjendjen ekonomike dhe financiare (vlera e përgjithshme monetare e punëve të realizuar në lëmin e kërkuar; kapitali i mjaftueshëm për realizimin e kontratës min 50% të vlerës së ofertës dhe raportet për gjendjen financiare të tenderuesit për tri vitet e fundit).

Ankesat tjera ishin ngritur mbi pretendimet se përzgjedhja e fituesit ishte bërë nga autoriteti kontraktues duke mos respektuar kriterin e çmimit më të lirë (në 3 raste). Më pas shtatë (7) ankesa kishin të bënin me vlerësimet për mos përmbushjen e standardeve për pranueshmërinë e përshtatshmërinë profesionale të saktësuara në dosjen e tenderit si: Vërtetimi i lëshuar nga ATK ku dëshmohet se OE nuk është në vonesë për pagimin e tatimit; Vërtetimi nga Gjykata etj.

Një ankesë më e veçantë e adresuar nga një operator ekonomik, kishte të bënte me pretendimet se ka pasur një kurdisje mes dy operatorëve ekonomik që kanë aplikuar në tenderin për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale për vitin 2013/2014, për regionin e Gjilanit. Ankuesi më tej arsyeton pretendimet e tij se dy operatorë ekonomikë kanë pasur kurdisje të dokumenteve dhe aranzhime të çmimeve në mes tyre duke abuzuar me pozitë dominuese duke shkelur jo vetëm Ligjin për Prokurimin Publik por edhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## **Tenderët për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe rajonale**

Projekti më i përfolur për favorizime dhe shkelje ligjore në vitet e fundit, është pikërisht tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës. Ministria e Infrastrukturës, ka aplikuar kritere që kanë favorizuar kompanitë të cilat kanë pasur tenderin në tre (3) vitet paraprake. Kjo ka ndodhur për shkak se në dosjen e tenderit, është kërkuar që kompania e cila oferton për njërin nga nëntë (9) llotet e tenderit, duhet të ofroj edhe referencë kontrata në vlerën e dyfishit të ofertës. Këto referenca duhet të jenë kontrata të implementuara në tri vitet e fundit. Gjithashtu referencat është dashur të jenë në lëmin e mirëmbajtjes së rrugëve nacionale dhe rajonale. Sipas kësaj kërkesë të dosjes së tenderit, asnjë kompani tjetër nuk kishte mundësi të pjesëmarrjes në tender, nëse nuk do të hynte në konsorcium me një nga kompanitë aktuale e cila bënë mirëmbajtjen e rrugëve. Kjo situatë ishte një monopol kur kihet parasysh se në tre vitet e fundit të njëjtat kompani kanë pas kontratat për mirëmbajtjen e rrugëve.

Qysh në shpalljen e njoftimit për kontratë, para se ofertat të dorëzohen, KDI/TIK pati ngritur zërin kundër këtij procesi të montuar, me arsyetimin se buxheti i Kosovës do të dëmtohej nga mungesa e konkurrencës. Gjithashtu kjo përbënte shkelje të parimeve ligjore të mos diskriminimit të operatorëve ekonomik dhe mos aplikimit të kriterëve favorizuese. Asnjë operator, i cili nuk hyn në konsorcium me këto nëntë (9) kompani të cilat aktualisht kishin tregun, nuk do të mund të shpallej si i përgjegjshëm në tender. Duke pas parasysh monopolin e kompanive, asnjë nuk do të kishte interesim të marr kompani në konsorcium, pasi kështu vetëm do të i pakësoheshin gjasat që vitin tjetër të marr prapë tenderin. Në situatën kur konkurrenca është e pa mundur, kompanitë mund të imponojnë çmimet e larta, varësisht nga vullneti i tyre.

Pas reagimit të KDI/TIK dhe ankesave të bizneseve në OSHP, kjo e fundit e vërtetoi pretendimin se kriteret në dosje janë favorizuese për këtë projekt. OSHP i kërkoi Ministrisë së Infrastrukturës që të bëjë ndryshimin e këtyre kriterëve duke i kërkuar që në kuadër të kriterëve teknike, tek referencat, të shtohet edhe mundësia që kompanitë të cilat kanë kontrata në lëmin e ndërtimit dhe asfaltimit të rrugëve. Ky vendim i OSHP-së më së miri demantoi deklaratimet e Ministrisë së Infrastrukturës e cila akuzoi KDI-në se në këtë rast po mbron agjendën e një biznesi të

caktuar. Ndryshimi i kriterëve në dosje të tenderit të paktën në letër hapi konkurrencën për të gjithë operatorët serioz, të cilët do mund të kishin interesim për të aplikuar në këtë tender.

Sidoqoftë, edhe përkundër këtij vendimi, procesi nuk u përcjell pa probleme. Kërkesa e KDI-së për qasje në dokumente zyrtare për të parë dokumentet e tenderit, është kufizuar dhe nuk është lejuar në tërësi. KDI nuk ka arritur të shoh ofertat e operatorëve ekonomik si dhe ka pranuar me një vonesë shumë të madhe dokumentet përcjellëse të tenderit, siç është dosja e tenderit dhe kontratat me disa operatorë ekonomik. Për shkak të mungesës së qasjes së plotë në dokumente zyrtare KDI është e detyruar që të jap opinion të rezervuar lidhur me këtë tender, pasi nuk kemi mundur t'i vërtetojmë të gjitha pretendimet tona.

### **1. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Prishtina A, Kontrata me Kompaninë Arbotec**

Në regjionin e Prishtina A, Kompania Arbotec ka fituar këtë tender pa konkurrencë, përkatësisht as një operator i përgjegjshëm nuk i ka konkurruar kompanisë në fjalë. Ministria e Infrastrukturës, ka bërë revokimin e nenit 32.5 i cili kërkon që në një procedurë tenderuese, të paktën dy oferta të jenë të përgjegjshme. Çmimi i kësaj kontrate është 1,298,973.80 euro. Nga raporti i vlerësimit të ofertave vërejmë se në këtë tender ka pasur edhe një ofertë të dytë, e cila është shpallur e pa përgjegjshme për arsye se i kanë munguar disa elemente bazë të ofertës siç janë Menaxheri i Projektit dhe personeli kryesorë teknik, pjesë e kërkesave teknike dhe profesionale të dosjes së tenderit. Në mungesë të qasjes në oferta këto nuk ka qenë e mundur të verifikohen.

Në anën tjetër në media ka rrjedhur raporti i auditorit të brendshëm për Ministrinë e Infrastrukturës, në të cilin është konstatuar se pikërisht në këtë projekt, Kompania Arbotec ka pasur mungesa në aplikacionin e saj dhe në ofertën që ka dorëzuar në Ministrinë e Infrastrukturës. Aty thuhet se Menaxheri i projektit nuk ka qenë kompetent pasi nuk ka pasur referenca në fushën e mirëmbajtjes së rrugëve. Certifikata e përfundimit të studimeve ka qenë e pa noterizuar, gjithmonë sipas këtij raporti.

Noterizimi i diplomës, ka qenë kusht në dosjen e tenderit dhe diçka e tillë në një rast tjetër do ta eliminonte kompaninë nga gara për tender<sup>1</sup>.

Problemi kryesorë edhe me këtë kontratë mbetet gabimi aritmetikor i cili ka bërë që çmimi i ofertës të rritet nga 1,140,633.80 euro në 1,298,973.80 euro. Ky dallim ka ngritur vlerën e kontratës për 158,340.00 euro. Pasi që Arbotec ishte oferta e vetme e përgjegjshme në këtë tender, atëherë edhe vlera e kontratës ka mundur të rritet sipas dëshirës. Gabimet aritmetikore në Ministrinë e Infrastrukturës, nuk janë aspak bindëse dhe nuk mund të konsiderohen si vërtetë të paqëllimshme. Kjo mund të jetë një nga mangësitë e Ligjit të Prokurimit Publik, në të cilën institucionet po mbështetën për të favorizuar bizneset e tyre të preferuara. Praktika e shfrytëzimit të gabimit aritmetik, nuk mbaron me këtë kontratë, pasi e njëjta është shfrytëzuar edhe në disa raste të tjera, qoftë duke ju rritur vlerën e kontratave operatorëve apo edhe duke e zbritur çmimin e një operatori sa për të nxjerr fitues përball konkurrentit më të lirë.

Në këtë tender ofertë ka paraqitur edhe kompania tjetër Integral. Megjithatë, kjo kompani është shpallur e pa përgjegjshme në këtë tender për shkak të mungesës së resurseve humane, të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për Ministrinë e Infrastrukturës. Në anën tjetër, kjo kompani është shpallur fituese për mirëmbajtjen e Rajonit Prishtina B. Me sa duket oferta në këtë llot ka qenë vetëm sa për të përmbushur kushtin ligjor prej dy ofertave, pasi mos emërimi i Menaxherit të Projektit dhe mungesat, janë gabime elementare për një operatorë i cili fiton tender të rëndësishëm në këtë Ministri. Madje edhe vlera e ofertës së kësaj kompanie për Prishtina A, dallon shumë nga ajo që ka paraqitur për Prishtinën B. Kështu kjo kompani ka ofertuar me 1,378,335.20 euro për Prishtina A, ndërsa me 948,374,24 euro në Prishtina B. Në rajonin Prishtina A, ishte dukshëm më e shtrenjtë edhe se kompania fituese, gjë e cila ngrit dyshimet se oferta është bërë vetëm për numër, pasi që ishte jo reale në kuptim të çmimit.

Duke u bazuar në këto të dhëna dhe të gjeturat e auditorit të brendshëm të Ministrisë, kjo kontratë do të duhej rishikuar nga Ministria e

---

<sup>1</sup> Raporti është publikuar në portalin koha.net, në linkun <http://koha.net/?id=27&l=1058> (për herë të fundit i qasur më 15.03.2014)



Infrastrukturës, në mënyrë që të shihet se sa realisht ka qenë i ligjshëm i gjithë procesi i tenderimit për këtë kontratë dhe të tjera pasuese.

## **2. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Prishtina B, Kontrata me Kompaninë Integral**

Operatori ekonomik i cili ishte shpallur i pa përgjegjshëm në tenderin paraprak për Regjionin Prishtina A, ka fituar në tenderin për mirëmbajtjen e Regjionit Prishtina B. Të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit sipas raportit të vlerësimit, ky operatorë i ka plotësuar në këtë tender. Ai madje ka pasur edhe konkurrencë shumë të dobët, pasi vetëm një operatorë i ka konkurruar në këtë tender, i cili përpos që ishte më i shtrenjtë, ai gjithashtu ishte krejt i pa përgjegjshëm duke mos plotësuar pjesën më të madhe të kushteve të dosjes së tenderit. Gjithashtu kjo ngrit dilema nëse operatori ka qenë serioz, apo edhe në këtë rast kemi pasur marrëveshje për të paraqitur dy(2) oferta me qëllim të plotësimit të kushtit ligjor, për minimumin e ofertave të parashtruara në secilin tender.

Një gabim super amator i Ministrisë së Infrastrukturës dhe vetë kompanisë fituese është kontrata e nënshkruar. Palët në të kanë kontratë kanë nënshkruar që kompania të bëjë mirëmbajtjen e rrugëve në Rajonin e Prizrenit dhe jo të Prishtinës B. Mos evitimi i këtij gabimi mund të kishte edhe dëme materiale, pasi që titulli i kontratës është në fakt edhe përmbajtja e kontratës. Të tilla lëshime janë krejt të pa pranueshme në kontratat me vlera milionëshe. Gabimet të tilla mbase do të toleroheshin në kontratat me vlerë minimale. Në këtë kontratë përveç Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës janë nënshkruar edhe vetë Ministri dhe Kompania Fituese, dhe asnjë nga palët nuk ka shmangur këtë gabim.



Ministria e Infrastrukturës është shumë precize kur vlerëson tenderët dhe aty vërehet se shpeshherë për gabime të vogla teknike, në nënshkrimin e ndonjë dokumenti apo specifikimin e vlefshmërisë së ofertës, kompanitë eliminohen përkundër çmimeve më të lira. Ndërsa nuk është njëloj e kujdesshme për të shmangur gabimet në kontratat e saja, të cilat janë kaotike dhe jo profesionale. Nga çmimet për njësi, vërehet se punët janë kontraktuar me çmime të ndryshme, me dallime të mëdha, kjo pasi që kompania Integral ka marr kontratë dyfish më të favorshme në çmimet për njësi sesa kompania Arbotec. Të njëjtat punë kanë dallime në dyfishin e çmimit (referohu në tabelën 1).

### **3. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin e Pejës, Kontrata me Kompaninë Graniti**

Në regjionin e Pjesës, kompania Graniti duket se nuk ka aspak konkurrencë. Kjo pasi që në këtë tender ajo ka ofertuar e vetme. Asnjë ofertë tjetër nuk ka pasur të përgjegjshme dhe as të papërgjegjshëm. Kompania nga Istogu ka siguruar këtë kontratë prej 958,478.54 € pa u munduar fare. Kjo kompani

është treguar edhe më e shtrenjtë se ajo Integral në shumë çmime për njësi, madje shumë fish më e shtrenjtë. Për shembull në kategorinë e 1.2 tek

**1m<sup>2</sup> riparim i rrugëve i kategorisë së njëjtë (Dëmtimet e mëdha), Ministrisë së Infrastrukturës diku i ka kushtuar 4.5 euro m<sup>2</sup> e diku 28 euro m<sup>2</sup>.**

Dëmtimet e mëdha 35-40 cm trashësi, kompania Graniti ka ofertuar çmimin 28 euro për M<sup>2</sup>. Kompania Integral kishte ofruar çmim prej 10 euro, ndërsa kompania Arbotec 4.5 euro. Të njëjtat punë janë kontraktuar me çmime shumë të ndryshme, gjë e cila shton një dyshim shumë esencial, pse riparimi i një grope në Pejë me 1M<sup>2</sup> kushton gjashtë fish më shtrenjtë sesa në regjionin e Prishtinës A.

Çmimet për njësi, janë pjesa më e ndejshme e kontratave të punëve, për shkak se në këtë formë kompanitë pas nënshkrimit të kontratave fokusohen në punët në të cilat kanë kontraktuar me çmime më të volitshme dhe refuzojnë të kryejnë apo lënë anash punët të cilat janë kontraktuar me çmime më të ulëta. Sido që të jetë, Kompania Graniti në të gjitha këto kategori, vetëm në njërën ka pasur çmim më të ulët sesa

kompanitë e tjera, gjë që dëshmon se ka qenë mjaftë e privilegjuar në raport me pesë kompanitë me të cilat i kemi krahasuar çmimet.

Nga raporti i vlerësimit të ofertave vërehet se kompania ka plotësuar të gjitha kushtet e dosjes së tenderit, mirëpo nuk ka pasur asnjë kompani tjetër konkurrenente. Kjo ka ndikuar që çmimi i kompanisë të jetë më i lartë në krahasim me shumicën e ofertave të tjera. Baza ligjore nuk e rregullon çështjen e çmimeve për njësi dhe në këtë mënyrë vijnë në shprehje çmimet e ndryshme për punët e njëjta. Kur çmimi shikohet në vlerën totale të kontratës nuk vërehet ndonjë dallim me kontratat e tjera, mirëpo në realizimin e saj, këto janë pjesët më të ndejshme të cilat bëjnë që me shumë më pak punë, një kompani të marr rreth 1 milion euro për mirëmbajtjen e rrugëve.

Nga Raporti i auditimit të brendshëm në Ministrinë e Infrastrukturës kanë rrjedhur edhe këto informata për shkelje në procedurën tenderuese: “gjatë rishikimit të dokumentacionit është vërejtur mungesë dokumentacioni –si vendimi ose kontrata mbi emërimin e menaxherit të projektit – kontratat e punës së personelit teknik si dhe mungojnë procesverbalet e pranimeve teknike për projektet e përfunduara dhe të dorëzuara të ofertës” thuhet në raport<sup>2</sup>.

Raporti hedh poshtë vlerësimin e Komisionit Vlerësues sepse ky operator ishte i papërgjegjshëm sipas Ligjit për Prokurimin Publik.

#### **4. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin e Prizrenit, Kontrata me Kompaninë Drini**

Se gabimet aritmetikore janë fushë e përshtatshme për favorizim më së miri tregon tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve në regjionin e Prizrenit. Gabimet aritmetikore kanë bërë që Kompania FAMIS nga Suhareka, e cila kishte ofertuar me çmimin më të lirë të mos e marr kontratën, kjo pasi që komisioni për shqyrtimin ofertave i Ministrisë së Infrastrukturës ka ardhur në

**Gabimet aritmetikore,  
çelësi i ‘fitimit’ të  
tenderëve**

---

<sup>2</sup> Raporti është publikuar në portalin koha.net, në linkun <http://koha.net/?id=27&l=1058> (për herë të fundit i qasur më 15.03.2014)

përfundim pas kalkulimit të çmimeve për njësi, se kompania Drini ka ofertën më të lirë. Në këtë mënyrë oferta totale e Kompanisë Drini është zbritur nga 899,317.84 euro në 894,387.84 euro. Në anën tjetër Kompania FAMIS kishte ofertuar me 898,733.20 euro. Ky korrektim i çmimeve ka ndikuar që oferta e kompanisë Drini të ulet vetëm në atë masë sa të fitoj kontratën dhe në këtë formë edhe një herë është dëshmuar se gabimet aritmetikore, janë vegëza të qëllimshme të cilat kompanitë i lënë në mënyrë që ti japin hapësirë komisioneve vlerësuese të rrisin apo ulin çmimin e tenderëve fitues sipas nevojës.

## **5. Mirëmbajtja e Rrugëve në rajonin e Ferizajt, Kontrata me Kompaninë Damastion-Eurokos-Urban-Unicom**

Mirëmbajtja e rrugëve në rajonin e Ferizajt ka përbushur kushtin ligjor për minimumin e dy ofertave të përgjegjshme. Dy kompani janë kualifikuar për këtë tender. Përveç kompanisë fituese në këtë tender ka marr pjesë edhe kompania RSM&JOOS Krasniqi. Të dy këto kompani janë nga Prishtina. Kompania fituese ka aplikuar me çmim prej 1,180,041.32 euro, ndërsa kompania tjetër RSM&JOOS Krasniqi ka ofertuar me çmim prej 1,393,397.80 euro.

Edhe një herë në këtë tender ka pasur gabim aritmetik. Oferta e kompanisë fituese është rritur nga 1,180,041.32 euro në 1,297,491.32 euro. Rritja e ofertës ka qenë e tillë që nuk e ka kaluar ofertën e dytë, megjithatë 117.450.32 euro, gabim aritmetik mbetet i dyshimtë, ashtu siç është edhe në rastet e tjera në këtë dhe tenderët e tjerë.

Problemet në përzgjedhjen e kësaj kompanie nuk përfundojnë këtu. Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Ofertave të Ministrisë së Infrastrukturës, Kompania Fituese Damastion-Eurokos-Urban-Unicom, ka pasur shumë mungesa në ofertën e saj. Në raport vërehet se kompania ka marr JO në këto pika: 1. Kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare, 2. Kërkesat teknike dhe/apo aftësitë profesionale, 3. Pasqyrat vjetore për të punësuarit në kompani nga ATK. Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit, ku është kërkuar numri minimal prej 25 punëtorëve.

Në raport është konstatuar se Tenderi është i pa përgjegjshëm me kërkesat teknike, mirëpo në fund është ranguar si i përgjegjshëm në

raportin e vlerësimit dhe ka fituar këtë kontratë. Se si kjo ka qenë e mundur, më së miri e din Ministria e Infrastrukturës.

## **6. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Mitrovicë, Kontrata me Kompaninë Jasen**

Kompania e përzgjedhur për mirëmbajtjen e rrugëve në regjionin e Mitrovicës B është kompania Jasen nga Zubin Potoku. Kjo kompani ka nënshkruar kontratë për 698,591.44 euro. Në këtë tender ka pasur edhe një ofertë të dytë nga Kompania Malsija ALB, mirëpo e cila është shpallur e pa përgjegjshme për shkak të një morie mungesash në ofertën e saj. Kjo kompani ka ofertuar me çmimin prej 687,621.32 euro. Sido që të jetë kompania Malsija ALB nuk ka pasur gjasa të marr këtë tender edhe po të plotësonte kushtet, pasi vet ndarja e Mitrovicës në dy regjione duket se për qëllim kryesor ka pas që tenderi t'i ndahet një operatori nga veriu, për shkak të problemeve që mund të ketë në zbatimin e kontratës në këtë pjesë të Kosovës, ku ka probleme serioze me sundimin e ligjit.

Kontrata me këtë kompani ka një numër të mungesave, pasi që aty nuk janë përfshirë çmimet e pikave 1.3a1, 1.3b1, 1.4a, kjo mbase nënkupton se këto shërbime nuk do të kryhen nga kompania në këtë pjesë të vendit, e që nënkupton se mirëmbajtja e rrugëve në veri të Kosovës do të jetë e pjesshme.

Nga ana tjetër kompania konkurrenente Malësia ALB, nga Istogu ka pasur mungesa në ofertën e saj në kërkesat teknike për mundësitë profesionale dhe teknike në realizimin e kontratës siç është: Menaxheri i Projektit, të cilit i kanë munguar referencat dhe ka pasur mungesë të depos së kripës. Të njëjtat arsye të komisionit vlerësues duket se janë vetëm arsyetime pasi që arsye kryesore pse ky operatorë nuk ka mundur të marr këtë kontratë është politike dhe Ministria e Infrastrukturës nuk ka dashur të ketë probleme të mëtutjeshme në realizimin e kontratës me operatorin.

Kompania Malësia &ALB është ankuar kundër vendimit të Ministrisë për të përzgjedhur si fitues kompaninë Jasen. Sipas kësaj ankese Kompania Malësia, përveçse ka qenë më e lirë për rreth 10,000.00 euro në total, ajo gjithashtu i ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit. Sipas tyre Kompania ka pasur Menaxherin dhe stafin kualifikuar me referencat e nevojshme dhe po ashtu kompania posedon

edhe depon për ruajtjen e kripës me sipërfaqe 780M<sup>2</sup>. Kompania i ka kërkuar OSHP-së të kthej lëndën në rivlerësim, duke u bazuar në pretendimet ankimore. Ajo po ashtu ka argumentuar se kanë munguar dy oferta të përgjegjshme, prandaj në këtë rast procedura ka qenë dashur të përsëritet dhe vetëm në rast se në ri-tenderim do të mungonin dy ofertat e përgjegjshme, atëherë do të mund të kërkohej revokimi i nenit për të vazhduar me procedurën e shpallës së një ofertë si fituese.

## **7. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Gjakovës**

Në procedurën e rregullt tenderuese, Kompania RSM dhe JOOS ishin shpallur fituese të tenderit me vlerën 1,379,125.02 euro. Sidoqoftë kompania konkurrenente e cila ishte shpallur e pa përgjegjshme në këtë tender, Victoria Invest, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me një mori shkeljesh të pretenduara, të cilat ishin bërë në fazën e parë të vlerësimit. Ajo ka argumentuar se i ka plotësuar kushtet e tenderit dhe se konkurrenti fitues RSM nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit. Në ankesën e këtij operatori të paraqitur në OSHP përmenden një varg çështjesh të cilat ndikuan që lënda pas ekspertizës të shkoj në ri-tenderim.

Në vazhdim në këtë ri-tender ndodhën çështje edhe më absurde bazuar në dokumentet e lëndës. Kompania ankuese Victoria Invest, këtë herë fitoi tenderin me 987,677.36 euro. Dallimi i fituesit të parë me të dytin përbënte një diferencë prej rreth 400.000 euro. Mirëpo kompani RSM e cila në ri-tender, humbi këtë kontratë, ka parashtruar ankesë në OSHP. Në këtë ankesë thuhet se operatori fitues Victoria Invest, ka aplikuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe mbi këtë bazë është dashur të shpallet si e papërgjegjshme.

Në këtë ankesë kompania ka argumentuar pretendimet e saj duke u bazuar në një numër çmimesh për njësi të cilat i ka ofruar kompania Victoria Invest. Po ashtu në këtë ankesë përmendet edhe një gabim aritmetikor, i cili e ka ngritur çmimin e ofertës nga 847,207.16 euro, në 987,677.36 euro, gjë që ka bërë që kontrata të nënshkruhet më shtrenjtë për rreth 140.000 euro. Në këtë ankesë përmenden një numër i madh i artikujve që janë ofruar me çmime jo normalisht të ulëta, si për shembull asfalt beton 0-16 mm përzierje të ftohët, çmimi i ofruar është 1.00 euro,

ndërsa çmimi mesatar në treg 100.00 euro. Kështu kompania sipas ankuesit ka aplikuar çmime paushall prej 1.00 euro në të gjitha punët e që realisht bënë që çmimi mos të jetë i vërtetë. Në këtë rast zbatimi i kontratës është i pamundur, me këto çmime të ofruara, të cilat as për së afërmi nuk janë reale, bazuar edhe në ofertat e tjera të këtij tenderi.

## **8. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Gjilanit**

Mirëmbajtja e rrugëve në të gjitha regjionet ka pasur probleme të cilat e kanë përcjell procedurën tenderuese, mirëpo për kah problemet asnjë regjion nuk mund të krahasohet me atë të Gjilanit. Nga tetë (8) ankesat që janë parashtruar nga operatorët ekonomik, katër (4) prej tyre kanë të bëjnë me kompanitë e regjionit të Gjilanit. Një numër i madh i shkeljeve pretendohen nga dy kompanitë kryesore konkurruese Tali dhe Magjistranja. Lënda madje nga çështja administrative, tani ka kaluar në penale, pasi palët kanë paraqitur lëndët në njësinë e krimeve ekonomike të Policisë së Kosovës dhe në Policinë e Eulex-it.

Kompania Magjistranja, në tri faza të ndryshme ka parashtruar tri (3) ankesa kundër vendimeve të Ministrisë së Infrastrukturës. Së pari, kompania është ankuar kundër kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit e të cilat diskriminojnë kompanitë e reja për pjesëmarrje në këtë tender. Ankesa është miratuar në favor të kompanisë dhe Ministria e Infrastrukturës është obliguar që të bëjë ndryshimin e kriterëve. Më pas, në fazën e shqyrtimit të ofertave kjo kompani është shpallur e pa përgjegjshme për shkak se raportet e saja të auditimit, sipas Ministrisë së Infrastrukturës kanë qenë të nënshkruara nga një kontabilist dhe jo nga auditori i certifikuar. Gjithashtu edhe bashkëpjesëmarrësi në ofertë Alb building ka pasur si mungesë raportin e auditorit për vitin 2011. Kompania është ankuar ndaj këtij vendimi dhe OSHP në ekspertizën e saj, i ka dhënë të drejtë kompanisë Magjistranja. Në anën tjetër për shkak të mungesës së dy ofertave të përgjegjshme i ka rekomanduar Ministrisë së Infrastrukturës, që lëndën të dërgoj në ri-tenderim.

Kompania Tali gjithashtu është ankuar në OSHP, duke pretenduar se i ka plotësuar të gjitha kushtet e tenderit dhe pa të drejtë është shpallur e pa përgjegjshme. Ajo madje ka akuzuar se shqyrtimi i ofertave nga komisioni ka qenë i ngutshëm dhe jo profesional për kompaninë

Magjistrerja, të cilës i kanë munguar disa të dhëna të rëndësishme në ofertën e saj. Kompania Tali ka argumentuar se vërtetimi i Gjykatës Ekonomike, nuk është i datës së duhur dhe është i dyshimtë për shkakun se në Gjykatë, kjo kompani ka konteste të hapura, vërtetimet tatimore dhe marrëveshja me partnerin Alb Building nuk ka qenë e detaizuar dhe punët nuk kanë qenë të specifikuar se si do të ndahen nga këta operatorë. Bazuar në ekspertizën e OSHP-së, kompanisë Magjistrerja i është bërë e pa drejtë në shqyrtimin e ofertave. Aty është bërë e ditur se dokumentet e saj kanë qenë të plota duke përfshirë edhe licencën e auditorit. Ministria e Infrastrukturës, ka qenë dashur që kompaninë ta shpërblej me kontratë, duke bërë revokimin e nenit 32.5 të Ligjit të Prokurimit Publik, ashtu siç ka vepruar në të gjitha llojet e tjera ku ka pasur vetëm një operator të përgjegjshëm.

Ky rajon më tutje është dërguar në ri-tender, ku fitues është shpallur kompania Tali. Ofertues tjetër në tender ishin kompania Magjistrerja dhe Kompania Integral. E njëjta kompani, Magjistrerja ka parashtruar edhe një herë ankesë në OSHP, në lidhje me këtë tender, pasi që është shpallur e pa përgjegjshëm, për shkak të raporteve të auditimit. Duke pasur parasysh ekspertizën nga procesi paraprak mund të konstatohet se kompania Magjistrerja nuk ka pasur arsye të shpallet e papërgjegjshme. Kompania Magjistrerja ka akuzuar dy kompanitë e tjera në këtë tender Tali dhe Integral, se kanë bërë kurdisje të tenderit, vetëm për të plotësuar kushtin e dy (2) ofertave të përgjegjshme. Këtë pretendim kompania e bazon në provat e ofertës së dorëzuar ku disa marrëveshje të kompanisë Integral ishin nënshkruar dhe noterizuar nga pronari i kompanisë Tali. Sa i përket çmimeve të ofertuara, Kompania e diskualifikuar Magjistrerja kishte qenë më e lira në dy rastet. Në ri-tender ajo ka ofertuar me 985,606.18 euro, përderisa kompania Tali ka ofertuar me 1,399,527.47 euro, Kompania Integral ka pasur çmimin më të lartë 1,469,656.60 euro. Përkundër faktit që kompania është ankuar në OSHP, Ministria e Infrastrukturës ka nënshkruar kontratën me kompaninë Tali, pasi e njëjta ka vazhduar me kryerjen e punëve në terren. Në rast se vërtetohen pretendimet e kompanisë Magjistrerja, për çka ka shumë të ngjarë, buxheti në këtë tender dëmtohet mbi 400.000.00 euro.



## **9. Mirëmbajtja e Rrugëve në regjionin Mitrovica A**

Në regjionin e Mitrovicës A, fitues është shpallur kompania Alko Impex, me çmim 1,386,640.10 euro. Qysh në njoftimin për dhënie të kontratës është lëshuar një gabim në të cilin, çmimi i kontratës njoftohet të jetë 1.386.64.10 euro. Ky gabim megjithëse teknik tregon seriozitetin që Ministria e Infrastrukturës tregon në raport me publikun dhe KRPP-në në të cilën e ka njoftuar dhënien e kontratës.

Edhe në këtë tender ka pasur ankesë, Kompania Shkoza është ankuar në OSHP në lidhje me vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës. Ky operatorë ka thënë ta ketë marr me vonesë dosjen e tenderit nga Ministria, të cilët e kanë dërguar vetëm pesë ditë para se të bëhet hapja e ofertave. Ai po ashtu është ankuar për rritjen e sigurimit të ofertës nga 3% në 60,000.00 euro. Sipas tij, ky kriter ka qenë diskriminues dhe ka pas për qëllim të kufizoj konkurrencën. Po ashtu operatori është ankuar edhe për faktin se sigurimi është dashur të bëhet në institucion bankarë dhe nuk janë pranuar sigurimet e kompanive përkatëse të sigurimit. Kjo kompani ka raportuar se është e dëmtuar në vlerë monetare prej 500,000.00 euro.

## **Dallimi i Çmimeve për Punët e Njëjta**

Në tabëlën e paraqitur në vijim, vërejmë një shpërputhje të madhe të çmimeve në këto pesë kontrata sa janë krahasuar. Të njëjtat punë paguhen me çmime shumë të ndryshme dhe dallimi në disa raste arrin në shtatë fish më shtrenjtë, siç është rasti i krahasimit të kontratës së kompanisë Arbotec në Prishtina A dhe kontratës së kompanisë Graniti i cili bënë mirëmbajtjen e rrugëve në regjionin e Pejës. Nga dallimi i çmimeve për njësi mund të nxirret një konkluzion i përgjithshëm se kontratat nuk janë reale dhe shqyrtimi i ofertave ka pasur mangësi. Në këtë rast ose kemi të bëjmë më çmime jo normalisht të ulëta nga një numër i operatoreve, ose Ministria ka lejuar që disa kompani të keqpërdorin pozitën e monopolit për të imponuar lartësinë e çmimeve. Në shembullin paraprak vërehet se kompania Graniti, nuk ka pasur asnjë kompani konkurrenente dhe kjo më së miri është reflektuar në çmimet për njësi.

Pika		Njësia	Çmi-met për njësi	Prishtina A Kompania Arbotec	Prishtina B Kompania Integral	Pejë Kompania Graniti	Prizren Kompania Drini	Mitrovica B Kompania Jasen
1.1a	Riparimi i, gropëzave, gjurmëve, plasaritjeve të shtresës qarkulluese deri në 5 cm trashësi	M <sup>2</sup>	€	4.00	9.00	8.00	6.00	5.00
1.1b	Riparimi i, gropëzave, gjurmëve, plasaritjeve të shtresës qarkulluese deri në 10 cm trashësi	M <sup>2</sup>	€	4.00	10.00	10.00	8.00	6.00
1.2	Dëmtimet e mëdha 35-40 cm trashësi	M <sup>2</sup>	€	4.5	10.00	28.00	10.00	15.00
1.3a	Shtresa e re qarkulluese, me trashës mesatare prej 50mm me gërryerje	M <sup>2</sup>	€	4.82	6.50	5.00	7.00	8.00
1.3a 1	Shtresa e re qarkulluese SMA, me trashës mesatare prej 50mm me gërryerje	M <sup>2</sup>	€	6.08	6.00	11.00		
1.3b	Shtresa e re qarkulluese, me trashës mesatare prej 70mm me gërryerje	M <sup>2</sup>	€	6.80	8.00	8.80	9.00	9.00
1.3b 1	Shtresa e re qarkulluese, me trashës mesatare prej 50mm me shtesa "Forta-FI" ose ekuivalente me gërryerje	M <sup>2</sup>	€	5.44	6.00	1.10	7.00	
1.4a	Shtresa qarkulluese: Riparimi i plasaritjeve dhe çarjeve (në çmim njësi të përfshirë hapja dhe pastrimi i plasaritjeve/çarjeve si dhe mbushja me bituminoze)	M <sup>1</sup>	€	0.20	0.20	2.80	0.50	
1.5	Riparimi i Skajeve	M <sup>1</sup>	€	2.00	1.00	1.0	0.50	1.00

Njohësit e fushës, përmendin edhe një të dhënë shqetësuese që sipas tyre kompanitë e përdorin për të përfituar nga këto kontrata. Për shkak se shumica e këtyre kompanive janë të njëjtat për një kohë të gjatë në mirëmbajtjen e rrugëve, ato edhe e njohin mirë gjendjen në të cilën janë rrugët nëpër regjionet përkatëse. Duke pasur këto njohuri dhe për shkakun se para masat e Ministrisë së Infrastrukturës nuk janë shumë të besueshme, ato aplikojnë çmime të larta në punët të cilat janë më të shpeshtat dhe më të nevojshme në regjionet e tyre dhe në anën tjetër vijnë çmime minimale për punët të cilat janë më të rralla. Në këtë formë totali i kontratës nuk duket edhe aq i ndryshëm, mirëpo në zbatimin e kontratave pastaj këto kompani përfitojnë nga çmimet e larta, duke u fokusuar në këto lloj të punëve për të cilat kanë aplikuar çmimet e larta.

### **10. Tenderi për Asfaltimin e rrugës lokale në fshatin “Suriganë”- Komuna e Istogut**

Tenderi për Asfaltimin e rrugës lokale në fshatin “Suriganë”- Komuna e Istogut është shpallur me 29.03.2012, kurse hapja e tenderit është bërë me 08.02.2012. Fitues i këtij tenderi është shpallur kompania “Conex Group” nga Prishtina, meqë rezultoi të ishte më e lira nga kompanitë e cilësuar si të përgjegjshme nga ana e komisionit për vlerësimin e tenderëve. Shuma me të cilën kishte aplikuar kjo kompani ishte 488.800.47 € dhe ishte vlerësuar nga ana e komisionit se kishte plotësuar të gjitha kërkesat ekonomike dhe teknike profesionale si dhe oferta e këtij operatori nuk kishte tejkaluar vlerën e parashikuar të buxhetit nga Agjencioni Kontraktues.

Për këtë tenderë kanë aplikuar 20 ofertues, dhe me këtë është garantuar konkurrenca e nevojshme për këtë projekt. Komisioni gjatë vlerësimit të tenderëve ka ardhur në përfundim se 12 operatorë ekonomik të kualifikohen si të papërgjegjshëm për shkak të mos plotësimit të kriterëve të kërkuara dhe të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Ndërsa tetë (8) operatorë tjerë ekonomikë janë kualifikuar si të përgjegjshëm pasi që plotësuan kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Arsyet e kualifikimit të disa operatorëve ekonomik si të papërgjegjshëm nga ana e komisionit vlerësues, kishin të bënin me mungesën e dokumenteve lidhur me përshtatshmërinë administrative si: forma e

plotësimin të formularit dhe periudha e vlefshmërisë së tenderit. Po ashtu për këtë vlerësim kishte ndikuar edhe mungesa e dokumenteve lidhur me përshtatshmërinë e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale të operatorëve ekonomik si: mungesa e dokumenteve të lëshuar nga Gjykata kompetente, Certifikata e TVSH-së, certifikata e një draft-kontrate mbi sigurimin e vend punishtes nga një kompani e licencuar. Në fund është vlerësuar edhe gjendja ekonomike dhe financiare si dhe aftësia teknike/profesionale e operatorëve ekonomik, ku janë konstatuar se mungojnë dokumente si: Dëshmia për kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës min 50% e vlerës së ofertës, certifikata e auditorit për 3 vitet e fundit, lista e punëtorëve të përhershëm të kompanisë e dhënë nga ATK-ja, përgatitja profesionale e stafit dhe dëshmitë për posedimin e pajisjeve të nevojshme për realizimin e Projektit.

Ndër kriteret më të shprehura që kanë ndikuar në kualifikimin e disa prej operatorëve si të pa-përgjegjshëm, ishte periudha e vlefshmërisë së tenderit e cila në dosjen e tenderit ishte përcaktuar të jetë jo më pak se 120 ditë, kurse 4 nga 12 operatorët ekonomik (OE: “Rukolli”, “Victoria Invest”, “Belvedere” dhe “Shkoza”) e kishin shënuar periudhën e vlefshmërisë së tenderit 90 ditë, ndërsa 2 operatorë tjerë: “Mirusha Company” dhe “Arfa”, nuk e kishin shënuar fare.

## Fituesi i tenderit

Gjithnjë sipas Raportit të komisionit për vlerësimin e ofertave, ky komision kishte rekomanduar operatorin ekonomik “CONEX GROUP” nga Prishtina, për kryerjen e punimeve për projektin “**Asfaltimi rrugës lokale në fshatin Suriganë – Istog**”, me arsyetimin se ky operator është ofertuesi ekonomikisht dhe teknikisht i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët në mesin e ofertuesve të përgjegjshëm. Është vlerësuar se çmimi i ofruar nga “Conex Group” në vlerën prej 488.800.47, nuk tejkalon buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit dhe si i tillë ky operatorë u shpall fitues dhe ka nënshkruar kontratën për realizimin e këtij projekti.

Megjithatë nisur nga pasqyrat buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012, për realizimin e këtij projekti del se ishte

përcaktuar shuma në vlerë prej 200.000 euro nga niveli qendror si dhe 45.000 euro nga niveli lokal përkatësisht komuna e Istogut, e që në total kap shifrën 245.000 euro. Në Dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit nga ana e autoritetit kontraktues ishin paraparë si të nevojshme për realizimin e këtij projekti rreth 570.000 euro. Përzgjedhje e ofertuesit për implementimin e këtij projekti me vlerën prej 243.800 euro më shumë sesa buxheti i miratuar nga ana e Kuvendit të Kosovës për vitin 2012, ngrit dilema se nga cilat burime buxhetore është realizuar ky projekt.

### **11. Tenderi për Asfaltimin e rrugës lokale në fshatin Prekallë - Trubohovc**

Tenderi për asfaltimin e rrugës lokale në fshatin Prekallë është shpallur me datën 14 qershor 2013 kurse hapja është bërë me datën 08 gusht 2013. Fitues i projektit është shpallur kompania Meti & Conex Group me çmim prej 798,706.75 euro. Kjo kompani është shpallur më e lira, nga të gjitha kompanitë e cilësuara si të përgjegjshme në këtë tender. Komisioni për vlerësimin e ofertave kishte ardhur në përfundim se oferta e kësaj kompanie i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderit.

Në këtë tender numri i kompanive që kanë ofertuar ishte 7. Nga të gjitha këto kompani komisioni ka diskualifikuar pesë nga to si të papërgjegjshme për shkak se të njëjtat nuk kanë arritur të plotësojnë një apo më shumë kushte të dosjes tenderuese. Në fakt kushtet e përcaktuara për operatorët ekonomik ishin të vështira, me çka vërtetohet më se miri përjashtimi i një numri kaq të madh të bizneseve nga gara. Është kërkuar që referencat e kompanisë të jenë sa dyfishi i ofertës, kjo ka ndikuar që shumë kompanitë më të reja dhe më të vogla të mos mund të aplikojnë për këtë tender. Kjo do të thotë se secila kompani e interesuar për aplikim duhet të plotësoj së pari kushtin e sjelljes së referencave që dëshmojnë se në tre vitet e fundit kompania ka pasur punë të kryera sa dyfishi i vlerës së ofertës që oferton. Gjithashtu është kërkuar që siguria e tenderit të jetë 30,000.00 euro. Këtë herë nuk është cekur se nga cili institucion duhet të bëhet, apo nuk është thënë që të bëhet ekskluzivisht nga institucionet bankare, ashtu siç zakonisht bënë Ministria e Infrastrukturës. Siguria e ekzekutimit të tenderit është kërkuar të jetë 10% e vlerës së ofertës. Aty gjithashtu është kërkuar që

kompania të ketë kapital të mjaftueshëm apo të paktën 50% të vlerës së ofertës. Aty po ashtu është kërkuar që kompania të ketë në shfrytëzim apo në pronësi bazën për prodhim të asfaltit me kapacitet 80t për orë dhe gurthyes me kapacitet 30M<sup>3</sup> për orë.

Vlera e këtij projekti prej 798,706.75 euro, ka tejkalluar buxhetin e paraparë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna, pasi që bazuar në planifikimet buxhetore, Ministria në pasqyrat buxhetore të saj ka pasur të planifikuara 400.00.00 euro, ndërsa komuna ka paraparë bashkë participimin me 60.000,00 euro të tjera. Gjithsejtë mjete të planifikuara kanë qenë 460.000,00 euro.

Kompanitë janë diskualifikuar për këto arsye: 1. Europa & Trasing Group, është diskualifikuar për shkak se raportet e auditimit nuk janë pranuar si të plota nga komisioni vlerësues dhe kompania nuk ka emëruar stafin nëpër pozita për të cilat duhet të punojnë punëtorët. 2. Shkoza F 7, nuk ka ofruar dëshmi referenca për punëve të kryera në vlerën e dyfishit të ofertës, po ashtu pajisjet teknike dhe stabilimentet nuk kanë qenë konform dosjes tenderuese, kompania nuk ka ofruar dëshmi se i plotëson kushtet e dosjes për prodhimin e asfaltit 80t për orë. 3. Victoria Invest Internacional, nuk ka plotësuar kushtin për të pasur kapital minimum 50% të vlerës së ofertës dhe siguria e tenderit e ofruar nuk ka mbuluar vlerën 30.000.00 euro. 4. Mirusga Company, nuk ka sjell raportet e auditimit për vitin 2011 dhe 2012. Kompania nuk ka plotësuar as kushtin për kapitalit prej 50% të vlerës së ofertës, nuk ka plotësuar kushtin e prodhimit të asfaltit dhe vlefshmëria e tenderit ka qenë nën 120 ditë. 5. Ilea-GR, nuk ka plotësuar kushtin për referencat, kapitalin e domosdoshëm, menaxherin e projektit etj.

Duke marr për bazë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe çmimet e kontratës arrijmë në përfundimin se kontrata ka tejkalluar vlerën e planifikuar buxhetore, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2013. Po ashtu , dosja e tenderit ka pasur shumë kushte dhe specifikime të cilat e kanë ulur konkurrencën ndër operatorë ekonomik. Në mënyrë të veçantë, të pa dobishme dhe te pa arsyeshme duken vlerësimet lidhur me opinionet e auditorëve, të cilat në disa raste komisioni i ka vlerësuar si të joadekuate raporte e auditorëve, e për çka realisht kompetenca e mbikëqyrjes së auditimit dhe raportimit financiar i përket në tërësi një ministrie tjetër e cila do të duhej të jepte vlerësimet për çështjet e raportimit financiar. Ministria e Infrastrukturës nuk është

autoritet as kompetent dhe as relevant për të vlerësuar auditorët kosovar dhe auditimin e kompanive, ajo thjesht duhet të shohë nëse auditimi është bërë ose jo.

## **12. Tenderi - Ndërtimi i rrugës Pejë Tërstenik**

Tenderi në fjalë ishte realizuar në një procedurë të hapur me nr i prokurimit MI-13-040-5-1-1, ( 07.05.2013) dhe ishte një kontrate me vlere të madhe, pra me një vlerë prej afër 2 milion euro. Për të marr këtë kontratë kishin konkurruar 8 kompani, prej të cilave, sipas raportit të vlerësimit, vetëm njëra ishte shpall si e papërgjegjshme. Në këtë garë kompania fituese doli “ VICTORIA INVEST INTERNATIONAL”, e cila kishte ofertuar me një çmim prej 1,833,184. E dyta sipas çmimit ishte kompania” Asfalti & Engineering Group “ me një ofertë prej 1,973,851, dhe e treta ishte kompania RSM Company me një ofertë prej 2,173,816. Kompania Asfalti @ Engineering Group, edhe pse kishte qen e dyta me radhë për nga çmimi , ajo ishte diskualifikuar në këtë tender, për shkak se nuk kishte plotësuar një nga kërkesat administrative të përcaktuara në dosjen e tenderit, e që ishte mungesa e sigurimit të tenderit përmes një institucioni bankar.

Menjëherë në këtë pikë, (dosja e tenderit neni13.1), MI kishte shkelur kriterin që vetë e kishte përcaktuar në dosje të tenderit, duke bërë përzgjedhje selektive të operatorëve ekonomik dhe duke eliminuar padrejtësisht kompaninë Asfalti & Engineering Group . Për pranimin e sigurisë së tenderit nga një kompanitë e licencuara të sigurimeve, KRPP si institucion përgjegjës ka dhënë një interpretim, duke i cilësuar ato si të pranueshme dhe të barabarta , njëjtë sikurse sigurimet e tenderit të realizuara përmes një institucioni bankar.

Ndërkaq, problemi i dytë që është vërejtur në këtë tender, është rritja e çmimit të ofertës së kompanisë fituese, e që ishte bërë pas korrigjimit të gabimit aritmetikor nga ana e MI-së ,një gjë e lejuar me LPP. Sipas ofertës së parë, çmimi nga kompania “VICTORIA INVEST NTERNATIONAL “ kishte qenë 1,833,184, ndërkaq përmes korrigjimit të gabimit oferta kishte arritur në 1,937,283, që do të thotë se çmimi ishte rritur për 104, 099 Euro. Po që se krahasohet çmimi i korrigjuar dhe po që se do të ishte pranuar siguria e tenderit për kompaninë Asfalti

& Engineering Group, këto dy kompani do të kishin qenë në një garë shumë të ngushte sepse kompania Asfalti & Engineering Group kishte ofertuar me 1,973,851, pra me një diferencë shumë më të vogël se sa ajo që ishte dukur në fillim. Ligji i Prokurimit Publik ka rregulluar çështjen e gabimeve aritmetikore në këtë formë: “Autoriteti kontraktues do të përmirësoj gabimet në një tender të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t’i dërgoj të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla”. Sidoqoftë në këtë Ministri, shumë tender janë përcjell me gabime aritmetikore, gjë që na bënë të dyshojmë nëse të njëjtat janë apo jo krejtësisht aritmetikore, ashtu siç arsyetohen në raportet e vlerësimit të ofertave.

Sipas analizave të KDI-së fenomeni i gabimeve aritmetikore nuk është i rrallë, dhe si duke ai nuk ndodhë rastësisht. Ky fenomen po përsëritet mjaftë shpesh, nganjëherë e duke e ulur çmimin e ofertës, e nganjëherë duke e rritur atë, me ç’rast shfrytëzohet më shumë si plan B, për përfitime të ndryshme e shumë shpesh për t’i favorizuar kompanitë e caktuara. Ndërkaq për shkak të shfrytëzimit të kësaj hapësire ligjore nga ana e autoriteteve kontraktuese, KDI është marr me këtë çështje dhe ka propozuar që gabimet aritmetikore të mos tolerohen fare apo të kufizohen në një mas të konsiderueshme, sepse shumë shpesh është parë, që kjo mundësi është keqpërdorur duke ngritur edhe koston e projekteve.



## **Rekomandime:**

- Të shtohet mbikëqyrja ndaj Ministrisë së Infrastrukturës nga KRPP dhe AKK, për të garantuar procese të rregullta të vlerësimit të ofertave nga komisionet vlerësuese dhe zyrtarët e prokurimit;
- Të hetohen gabimet aritmetikore të operatorëve ekonomik, nëse të njëjtat janë apo jo të vërteta;
- Të rritet transparenca e Ministrisë së Infrastrukturës, respektimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit të Prokurimit Publik;
- Të merren masa ndaj nëpunësve të Ministrisë të cilët nuk zbatojnë legjislacionin përkatës, për transparencë;
- KRPP në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, të rregulloj çështjen e çmimeve për njësi, për të pamundësuar pagesat e ndryshme për punët e njëjta;
- Të mbikëqyret dhënia e kontratave me çmime jo normalisht të ulëta dhe kontratat ku çmimet janë shumë të larta në raport me çmimet e tregut;
- Të mbikëqyren njësitë e kërkesës dhe prokurimi i Ministrisë në hartimin e kriterëve diskriminues të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe pjesëmarrjen në tender;
- Ministria e Infrastrukturës të shtoj monitorimin e zbatimit të kontratave dhe në rastet e vonesave të aplikoj gjoba për operatorët ekonomik;
- Të shmangen kërkesat e dokumenteve të panevojshme në dosjet e tenderit, me qëllim të lehtësimit të vlerësimit të tenderëve dhe eliminimin e parregullsive në proces;
- T'i kushtohet vëmendje operatorëve të cilët paraqesin oferta fiktive, vetëm sa për të plotësuar kushtin ligjor për dy oferta të përgjegjshme;

- Sigurimi i tenderit të pranohet edhe nga kompanitë e sigurimeve, të mos kërkohet ekskluzivisht nga institucioni bankar;
- Anulimi i procedurave tenderuese të jetë i arsyetuar mirë dhe kjo të mos keqpërdorët për të dëmtuar fituesit e tenderëve.

**Instituti Demokratik i Kosovës - KDI**  
**Transparency International Kosova – TIK**  
Rruga Bajram Kelmendi Nr. 38  
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381(0) 38 248 038  
[info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
[www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)